

LIGJ
Nr.9398, datë 12.5.2005

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8454, DATË 4.2.1999 "PËR AVOKATIN
E POPULLIT", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8600, DATË 10.4.2000**

Në mbështetje të neneve 81 pikat 1 dhe 2 shkronja "a" dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", ndryshuar me ligjin nr.8600, datë 10.4.2000, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në fund të nenit 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Avokati i Popullit kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligje të veçanta."

Neni 2

Në fund të nenit 4 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Para marrjes ose rimarrjes së detyrës, Avokati i Popullit bën betimin para Kuvendit. Formula e betimit është:
"Betohem se gjatë kryerjes së detyrave të mia do të mbroj kurdoherë liritë dhe të drejtat themelore të njerëzve pa dallim, në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet e Republikës së Shqipërisë."

Neni 3

Në fund të nenit 13 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:
"Në rastet kur Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet dhe kur kujdestari ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk vepron, nuk kërkohet pëlqimi i të dëmtuarit kur është i mitur ose i paafte mendërisht apo me aftësi të kufizuara ose për mbrojtjen e të drejtave të një numri të madh të individëve.
Në mbrojtje të interesave të një komuniteti të gjerë, të cilët mund të preken nga procedimi administrativ, Avokati i Popullit ka të drejtë të fillojë një procedim administrativ dhe të marrë pjesë në të, në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurës Administrative."

Neni 4

Në nenin 14, pas fjalës "organeve" shtohen fjalët "të cilat duhet t'u përgjigjen kërkesave të tij sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 ditë."

Neni 5

Në nenin 19 bëhen këto shtesa:
1. Në fund të shkronjës "a" shtohen fjalët "përfshirë edhe hyrjen në çdo zyrë të institucioneve publike dhe këqyrjen në vend të akteve ose dokumenteve që kanë lidhje me çështjen që heton."
2. Në fund të shkronjës "c" shtohen fjalët "dhe të thërrasë në zyrën e tij të gjithë personat pa

imunitet.”.

3. Në fund të nenit shtohet fjalia:

“Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme.”.

Neni 6

Pas nenit 19 shtohet neni 19/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 19/1

Avokati i Popullit ose personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar (të paraburgosurit), në reparte ose në institucione shtetërore, në spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet ose mbahet në këto mjedise.

Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Avokatin e Popullit nuk duhet të pengohet ose të kontrollohet.”.

Neni 7

Në nenin 21 bëhen këto shtesa:

1. Në fund të shkronjës “b” shtohet fjalia “Paraqitja e rekomandimit pezullon aktet ose veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit.”.

2. Në fund të shkronjës “c” shtohet fjalia “Mosshqyrtimi i rekomandimit brenda 30 ditëve pezullon aktet ose veprimet e paligjshme ose të parregullta.”.

3. Në fund të shkronjës “ç” shtohen fjalët “ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara.”.

Neni 8

Në fund të nenit 22 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Avokati i Popullit duhet të njoftohet dhe ka të drejtë të marrë pjesë e të flasë në mbledhjet e organeve kolegjiale të administratës publike, ku merret në shqyrtim rekomandimi, kërkesa apo propozimi i tij.”.

Neni 9

Pas nenit 22 shtohet neni 22/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 22/1

Sanksionet për mosbashkëpunimin me Avokatin e Popullit

Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.”.

Neni 10

Në nenin 24, shkronjat “b” dhe “c” ndryshohen si më poshtë:

“b) t'u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mosshqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktajnë shkelje të të drejtave dhe lirive.

c) të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e akteve të tilla.”.

Neni 11

Në nenin 25 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në paragrafin e dytë hiqen shkronjat “a” dhe “c”.

2. Paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

“Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit.”.

Neni 12

Në fund të nenit 26 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Raporti vjetor për vitin pasardhës duhet të paraqitet jo më vonë se 30 prilli i vitit në vazhdim.”.

Neni 13

Në fund të nenit 34 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Këta mund të shkarkohen edhe me kërkesën e Avokatit të Popullit para mbarimit të afatit 3-vjeçar për shkelje në detyrë apo sjellje dhe akte që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tyre.”.

Neni 14

Në fund të nenit 35 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Avokati i Popullit dhe tre komisionerët përfitojnë falas Fletoren Zyrtare.”.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4603, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**